

FORCIMI I EDUKIMIT PËR QYTETARI DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI

PËR MË SHUMË INFORMACION:

 <https://www.coe.int/sq/web/tirana/home>

 Council of Europe Office in Tirana

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës "Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri", i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

SQI



Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Projekti "Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri" zbatohet nga Këshilli i Evropës (KfE) dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) është partneri kryesor në zbatimin e projektit.



OBJEKTIVI YNË

Synojmë të përmirësojmë cilësinë e arsimit në sistemin parauniversitar në Shqipëri, duke forcuar edukimin për qytetari demokratike, në përputhje me standardet dhe praktikën e Këshillit të Evropës.



KUSH DO TË PËRFITOJË?

Politikëbërësit e arsimit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, mësuesit, prindërit, si dhe stafi i shkollave pilot të ciklit të Arsimit të Mesëm të Ulët, të Arsimit të Mesëm të Lartë, komunitetet lokale e të tjera.



KOHËZGJATJA DHE BUXHETI

Projekti ka filluar në dhjetor 2019 dhe pritet të përfundojë më 31 maj 2026, me një buxhet prej 2,259,699.00 Eurosh.



ÇFARË DO TË BËJMË?

Bazuar në veprimtaritë e mëparshme të bashkëpunimit të Këshillit të Evropës në Shqipëri, projekti do të përkrahë reformën aktuale të kurrikulave shkollore në sistemin e arsimit parauniversitar, që bazohet në kompetenca, si dhe në metodën e mësimdhënies me në qendër nxënësin.

Objekti i projektit do të përmbushet përmes një sërë veprimtarish, që synojnë përmirësimin e politikave dhe të praktikave arsimore në tri fusha: mbështetja e politikave arsimore, qeverisja demokratike e shkollave, mbështetja e mësuesve.



MBËSHTETJA E POLITIKAVE ARSIMORE

Analiza gjithëpërfshirëse e arsimit për qytetari demokratike në sistemin e arsimit parauniversitar në Shqipëri me qëllim identifikimin e mundësive dhe të sfidave për harmonizimin e mëtejshëm të kurrikulave kombëtare me parimet e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe të Edukimit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës.



QEVERISJA DEMOKRATIKE E SHKOLLAVE

75 shkolla pilot do të mbështeten në hartimin dhe zbatimin e praktikave të qeverisjes demokratike, për të krijuar një mjedis mësimdhënës më gjithëpërfshirës e më inkurajues për të gjithë nxënësit në shkollë. Synojmë të mbështesim nisma të drejtuara nga vetë nxënësit, duke u përqendruar në temat: qytetaria digjitale, edukimi mediatik, siguria në internet, lufta kundër bullizmit, mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme, ndryshimet klimatike e të tjera.



MBËSHTETJA E MËSUESVE

Përqendrohet në zhvillimin e aftësive profesionale të mësuesve, të qëndrimeve dhe praktikave të tyre, në mënyrë që të përmirësojnë më tej kompetencat për kulturë demokratike të nxënësve në klasë.

VITI 2020

Analiza gjithëpërfshirëse e politikës dhe e kurrikulës së Edukimit për Qytetari Demokratike në përputhje me objektivat arsimore kombëtare e njëherësh me standardet e EDQ-së dhe EDNj-së të Këshillit të Evropës; mbështetje Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për krijimin e rrjetit të shkollave demokratike dhe gjithëpërfshirëse; konferencë kombëtare për Edukimin për Qytetari Demokratike; përzgjedhja e 25 shkollave të para pilot; krijimi i rrjetit të mësuesve TeacherNet; skema e granteve të vogla për OSHC-të e të tjera.

VITI 2021

Mbështetje MAS-it për integrimin e objektivit për zhvillimin demokratik të shkollave në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026; konferenca prezantuese e rrjetit të mësuesve TeacherNet; konkurs për reportazhe të krijuara nga nxënësit; përzgjedhja e 25 shkollave të raundit të dytë dhe shpallja e skemës së granteve për OSHC-të; forumi i përvitshëm për reflektim e shkëmbim përvojash për shkollat pjesëmarrëse në projekt e të tjera.

VITI 2022

Konferencë rajonale për politikën dhe praktikën arsimore më të mira në Edukimin për Qytetari Demokratike; veprimtari për forcimin e kompetencave demokratike të nxënësve, si: shkëmbime përvojash, shkolla verore/dimerore, konkurse; raundi i tretë përzgjedhjes së shkollave pilot dhe granteve për OSHC-të; kurse trajnimesh dhe seminaresh online për mësuesit në Portalin e Arsimit të KiE-së dhe të ASCAP-it e të tjera.

VITI 2023

Film i shkurtër dokumentar; publikimi dhe shpërndarja në nivel kombëtar i praktikave më të mira për qeverisjen demokratike të shkollave pjesëmarrëse në projekt; kurse trajnimesh dhe seminaresh online për mësuesit në Portalin e Arsimit të KiE-së dhe të ASCAP-it; shkëmbime të praktikave të mësuesve në nivel rajonal; veprimtari për nxënësit.

VITI 2024

Kurse trajnimesh dhe seminaresh online për mësuesit në Portalin e Arsimit të KiE-së dhe të ASCAP-it e të tjera; nismë ndërgjegjëse "Mësojmë nga e kaluara"; shkëmbime të praktikave të mësuesve; veprimtari për forcimin e kompetencave demokratike të nxënësve.

VITI 2025

Angazhimi i aktorëve të arsimit për zbatimin e Vitit Evropian të Edukimit për Qytetari Digjital 2025; pajisja e 17 shkollave me Laboratorë të Kulturës Demokratike me udhëzime të unifikuara metodologjike dhe operacionale të hartuara nga projekti dhe të miratuara nga ASCAP dhe MAS; mbështetje e politikave për MAS-in për autonominë financiare të shkollës; nismë ndërgjegjëse "Mësojmë nga e kaluara"; kurse trajnimesh dhe seminaresh online për mësuesit në Portalin e Arsimit të KiE-së dhe të ASCAP-it e të tjera; nisma të drejtuara nga vetë nxënësit duke përfshirë iniciativën Vullnetarizmi Digjital.

VITI 2026

Kurse trajnimesh dhe seminaresh online për mësuesit në Portalin e Arsimit të KiE-së dhe të ASCAP-it e të tjera; veprimtari për nxënësit; konferenca përmbyllëse për prezantimin e rezultateve të projektit.